



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.811 /19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z.Nuhi Paçarizi - Kryetar, z.Blerim Dina– Referues, z. Goran Milenković-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Malesia”- Istog, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE: “ER-Lis” sh.p.k& NNT “EingCom”-Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal” me nr. prokurimit: 644-18-8683-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi Komunal Vushtrri, më datë: 13.01.2020, mori këtë:

## V E N D I M

**I. APROVOHET**, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Malesia”- Istog, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal” me nr. prokurimit: 644-18-8683-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi Komunal Vushtrri.

**II. VËRTETOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal” me nr. prokurimit: 644-18-8683-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi Komunal Vushtrri.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues ër të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Malesia”- Istog, aprovohet pjesërisht si e bazuar , i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Sqarim rreth inicialeve për procesin e prokurimit :

Autoriteti kontraktues në tekstin e më poshtëm AK ;

Operatori ekonomik në tekstin e më poshtëm OE ;

Dosja e Tenderit në tekstin e më poshtëm DT ;

Njoftimi për Kontratë në tekstin e më poshtëm NJpK ;

Ligji për Prokurim Publik-në tekstin e më poshtëm LPP;

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publikenë tekstin e më poshtëm- RRUOPP;

Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik, në tekstin e më poshtëm –KRPP;

Organi Shqyrtues i Prokurimit në tekstin e më poshtëm-OSHP;

Paneli shqyrtues në tekstin e më poshtëm – PSH;

Operatori ekonomik ankues “Malesia”- Istog,si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 15.11.2019 me nr811/19,kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:“Sinjalizimi horizontal dhe vertikal” me nr. prokurimit: 644-18-8683-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi Komunal Vushtrri, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, 59 dhe 72të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenet 39 dhe 41 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.12.2019, ka autorizuar eksperteprofesionale të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.



Ekspertja profesionale e prokurimit në raportin e dt:26.12.2019 sqaron si në vijim,

### **Përgjigje në Pretendimi nr.1**

OE ankues "Malësia NPG", pretendon se Kuvendi Komunal Vushtrri, nuk ka respektuar nenin 1 të LPP-së, sipas OE ankues. Pasi që e ka shpallur fitues OE "ER-LIS" SH.P.K-NNT "EingCom".

I njëjti pretendon se AK-së duhet të ketë në konsideratë qëllimin e këtij ligji ku dihet se qëllim i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë

Ekspertja thekson se qëllim i këtij neni është të sigurojë mënyrë ma efikase, me transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, duke përcaktuar kushtet rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, te drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen, andaj trajtimi i OE, ankues si OE i Eliminuar pasi që nuk i ka plotësuar kriteret e parapara me NJ.K. dhe D.T. është në harmoni me nenin 1 të LPP-së.

Andaj Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pabazuare.

### **Përgjigje në Pretendimi nr.2**

OE ankues "Malsia NPG", pretendon se Kuvendi Komunal Vushtrrisë, nuk ka respektuar nenin 6 të LPP-së, sipas OE ankues. Ekspertja thekson se qëllim i këtij neni është të sigurojë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë me ekonomike, duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit. Andaj trajtimi i OE ankues i eliminuar është në harmoni me nenin 6 të LPP-së. (arsyet e eliminimit do sqarohen me poshtë konkretisht në pretendimet nr.4, nr.5 dhe 6.) Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pabazuar.

### **Përgjigje në Pretendimi nr.3**

E ankues "Malsia NPG", pretendon se Kuvendi Komunal Vushtrri, nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së, ky nen është shkelur pasi që AK-ja nuk i ka vlerësuar të gjithë OE njësoj, sipas OE ankues.

Qëllimi i neni 7 të LPP-së është që AK. të trajtojë Operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë, pa diskriminim dhe në mënyrë transparente.

AK-së gjatë Ri-vlerësimit, Operatorin Ekonomik ankues, e ka trajtuar si OE. të eliminuar ngase ishte ofertë me gabime në kalkulim mbi normën e lejuar +-2%, duke sqaruar se kjo ishte vërtetuar edhe nga paneli shqyrtues përkatësisht me vendimin PSH.nr. 465/19 të datës 08.10.2019 ishte ofertë me gabime që

tejkalon normën e lejuar andaj edhe nuk i plotëson kriteret e parapara me NJ.K. dhe dosjen e tenderit. Andaj Ekspertja konstaton se pretendimi i OE ankues nuk qëndron dhe është i pa bazuar .

#### **Përgjigje në Pretendimi nr.4 nr. 5 dhe 6**

E ankues "Malsia NPG", pretendon se Kuvendi Komunal Vushtrri, nuk ka respektuar nenin 39 të Rregullat e Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik ,(s qarimi i tenderëve )sipas OE. Ankues dhe nenin 59 i LPP-së si dhe neni 41 i RRUOPP-it (Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve )

Qëllimi i nenit 39 të RRUOPP-së është që të lehtësohet vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve dhe bazuar në këtë nenë AK-së mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht sqarime për ofertën e tij lidhur me dokumentet që mungojn ,qartësimi të deklaratave të paqarta ,certifikatave të përfshira në tender gjithashtu edhe mund ta ftoj OE. që të plotësoj apo qartësoj dokumentet e paraqitura në pajtim me nenin 65-71 të LPP-së.

Në nenin 39 të RRUOPP-ik janë sqaruar në mënyrë tabelore se çka mund të kërkohet dhe për çka refuzohet tenderi .

Ekspertja thekson se qëllimi i nenit 59 të LPP-së dhe nenit 41 të RRUOPP-it është Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve ,fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të Rivlerësimit i cili OE. ankues e ka trajtuar si OE. të eliminuar dhe trajtimi si OE i eliminuar Operatorin ekonomik ankues është në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe nenin 41 të RRUOPP-it.

Ekspertja sqaron se pikërisht neni 39 i RRUOPP përkatësisht pika 39.2 e rregullon-sqaron këtë pikë pretenduese shih piken 39.2 Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt të tenderit nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet .

Lidhur me pretendimin e OE. ankues, nëse analizohet siç e ka dorëzuar ofertën fillimisht në mënyrë fizike dhe pretendimin që tani edhe ja ka bashkangjitur ankesës me përshkrimin e çmimit shihet qartë se është ndryshuar tërë oferta të çmimi për tvsh.

Kurse neni 39.2 siç e potencova më lart nuk lejon që të bëhet asnjë ndryshim në çmim .

OE ankues te plotësimi i përshkrimit të çmimeve ka gabuar sepse :

OE ankues nuk e ka përdor tabelën (përshkrimin e çmimeve) të krijuar nga AK-së në platformën e-prokurimit ose e ka përdor tabelën por nuk ju ka përmbajtur udhëzimit që ishte dhënë se si të plotësohet tabela sepse udhëzimi ishte:

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G

Në kolonën F duhet të plotësoni duke shkruar normën e tvsh-së vetëm si numër si 0,8 ose 18 e jo në formatin 0% ,8%,apo 18%,



Ndërsa në kolonën G duhet ta plotësoni me çmim për njësi me tvsh, çmimin duhet ta shkruani me dy decimale pas presjes dhjetore .

OE .ankues nëse e ka përdor përshkrimin e çmimit të krijuar nga AK-së përmes platformës së e-prokurimit, te çmimi për njësi me tvsh e ka dhënë çmimin që përputhet me totalin e çmimit të ofertës, mirëpo i njëjti gabimisht te norma e tvsh nuk ju kishte përmbajtur udhëzimit dhe gabimisht e ka shkruar vlerën e tvsh-së e jo sikurse ishte udhëzuar ta paraqet vetëm me 0.8 ose 18 andaj edhe tabela formula e ndryshon edhe çmimin për njësi dhe me këtë veprim ndryshohet tërë oferta sepse ndryshohet çmimi për njësi pa tvsh dhe bazuar në këtë çmim ndryshon tërë oferta dhe bien ndesh me pikën b të nenit 41 të RRUOPP-it ku ekskluzivisht e përcakton se „Në asnjë rast çmimi për njësi nuk mundë të korrigjohet. Në rast se tenderuesi pretendon se ka bërë në gabim në çmimin për njësi, tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet i tërhequr”.

Por edhe në rast se OE .ankues fare nuk e ka përdor Tabelën (përshkrimin e çmimeve ) të krijuar nga AK-së por ka krijuar tabelë vetë në Exel prapë se prapë ka vepruar gabimisht sepse Dallimi i gabimit aritmetik e tejkalon normën e lejuar +, - 2% duke u bazuar në Nenin 59 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ,

Ekspertja e prokurimit ka kalkuluar vetëm 4 pozicione si me ekspertizën paraprake dhe ka analizuar edhe pretendimet e OE ankues në tabelën e dorëzuar me ankesë dhe vjen në përfundim se OE .ankues gabimisht e ka ndryshuar tabelën -përshkrimin e çmimit ku e ka ndryshuar komplet çmimin për njësi duke dhënë vlera për njësi që i përshtaten totalit të çmimit që kjo nënkupton ndryshim të ofertës.

**Totali i ofertës i dhënë nga OE me rastin e dorëzimit të ofertës:**

Totali i çmimit pa tvsh = 62,484.52 €

Totali i TVSH-së = 3,764.04 €

Totali i çmimit me TVSH = 66,248.56 €

**Totali i ofertës i korrigjuar nga OE. me rastin e dorëzimit të ankesës:**

Totali i çmimit pa tvsh = 56,321.32 €

Totali i TVSH-së = 9.927.24 €

Totali i çmimit me TVSH = 66,248.56 €

Dallimin në kalkulim te totali i çmimit pa tvsh është ma tepër se +- 2%

62,484.52 – 56,321.32 = 6,341.67 € dmth gabim në kalkulim sipas ofertës së dorëzuar nga OE. ankues dhe ofertës së korigjuar me ankesë nga vetë OE. ankues është 6,341.67 € kurse Norma e lejuar e gabimit aritmetik sipas formulës  $56,142.85 * 2\%$  është 1,122.85 €

Këto të gjetura pa e përdor kalkulimin paraprak të cilin e kam bërë vërtetohet se gabimet në kalkulim e tejkalojnë normën e lejuar, që norma e lejuar për gabime gramatikore është deri 1,122.85 € kurse vet OE ankues ka konstatuar se ka gabime te totali pa tvsh gabimi është në vlerë prej 6,341.67 €

Mbi këtë bazë është vërtetuar se ka gabime në kalkulim mbi normën e lejuar andaj Ekspertja e prokurimit konstaton se AK-së me rastin e Ri-vlerësimit ka nxjerr vendim konform LPP-së dhe RRUOPP-ik

Kalkulimi paraprak nga ekspertja e prokurimit i vetëm 4 pozicioneve me tabelë duke filluar kalkulimin nga çmimi për njësi pa tvsh duke e nxjerr tvsh-në pastaj çmimin për njësi me tvsh pastaj çmimi total me tvsh dhe çmimin total të dhënë nga OE ankues dhe në fund ndryshimin e totalit.

Operatori Ekonomik : Malsija NPTGN.									
Nr	Përshkrimi i pozicioneve	Njësi	Sasi	Çmimi për njësi € (pa tvsh)	TVSH (%)	Çmimi i njësi me TVSH €	Çmimi total me TVSH € (llogaritur nga Ekspertja Prokurimit)	Çmimi total me TVSH € (dhënë nga OE)	Ndryshimi i totalit të çmimit
1	A1- Vijë e plotë e pandërprerë b=120mm	m	3800	1.79	0.32	2.11	8,026.36	6,840.00	1,186.36
2	A2 vijë e ndërprerë b=120mm (e mesit)	m	7200	0.90	0.16	1.06	7,646.40	6,480.00	1,166.40
3	A3 Vendkalim të kombësorve (me paravijëzim)	m	580	7.89	1.42	9.31	5,399.92	4,640.00	759.92
4	A4 Shenjatërthorenë rrugë (vijë e ndalimit) me gjerësi 500mm	m	72	7.89	1.42	9.31	670.33	156.00	514.33
Totali Përgjithshëm							21,743.01	18,116.00	3,627.01

Totali i përgjithshëm i dhënë nga OE	18,116.00
Dallimi në kalkulim OE-Komisioni i Rivlerësimit (vetëm për 4 pozicione)	(3,627.01)

Norma e lejuar e	2%
------------------	----



gabimtaritmetik (per 4 pozicione)	362.32
-----------------------------------	--------

Konstatim: Dallimi i gabimit aritmetik e tejkalon normën e lejuar  $\pm$ , - 2% Duke u bazuar në Nenin 59 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 , Ekspertja e prokurimit ka kalkuluar vetëm 4 pozicione dhe është vërtetuar se ka gabime në kalkulim mbi normën e lejuar.

Kurse OE ankues gabimisht pretendon se ka gabime vetëm në TVSH. dhe për të njëjtat nuk vlen rregulla  $\pm$  2% ,sikur të ishte gabimi vetëm në TVSh .do ishte në rregull dhe te njëjtat nuk do kishin paraqitur problem sepse është e qartë dhe për të njëjtin çështje jo vetëm se ka jep interpretim KRPP-ja por ajo çështje është e gjykuar sepse ka vendim nga OSHP-ja që gabimet në TVSH . i ka trajtuar si gabime që nuk hyjnë te rregulli  $\pm$ 2%, ,mirëpo rasti i juaj hyn te gabimet në kalkulim siç e sqarova më lart te totali pa TVSh sepse e tejkalojnë normën e lejuar .

OE ankues ka vepruar në këtë mënyrë duke i ndryshuar çmimet për njësi shih vetëm katër pozicionet e para :

Pozicioni 1 çmimi për njësi në vend të çmimit 1.79 ju e ka ndryshuar në çmim 1.53

Pozicioni 2 çmimi për njësi në vend të çmimit 0.90 ju e ka ndryshuar në çmim 0.76

Pozicioni 3 çmimi për njësi në vend të çmimit 7.89 ju e ka ndryshuar në çmim 6.78

Pozicioni 4 çmimi për njësi në vend të çmimit 7.89 ju e ka ndryshuar në çmim 6.78

Kështu kishte vepruar në të gjitha njësit dhe gabimisht e kishte ndryshuar tërë ofertën .

Ky pretendim bien në kundërshtim me pikën b të nenit 41.9 të RRUOPP-kë, Ekzaminimi ,vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve ,ku ekskluzivisht e rregullon këtë çështje te njëjtin normë po e citoj si :

„Në asnjë rast çmimi për njësi nuk mund të korrigojohet .Në rast se tenderuesi pretendon se ka bërë një gabim në çmim për njësi ,tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet i tërhequr”

Ekspertja sqaron se dispozita e nenit 41.9 pika b. vetëm e përcakton se çmimi për njësi nuk mund të korrigojohet dhe se në rastin kur tenderuesi pretendon se ka bërë një gabim në çmim për njësi ,tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet i tërhequr”andajLigji dhe RRUOPP.-kë nuk flasin veç e veç për çmim për njësi pa TVSh dhe çmim për njësi me TVSh.andaj mbi këtë bazë ligjore vij në përfundim se sipas

kësaj dispozite nuk ka ndonjë ndarje që do të lejonte korrigjimin e çmimeve për njësi pa TVShsiç ka vepruar OE.ankues në tërë ofertën.

Andaj shpresoj se me këtë sqarim do të hiqen të gjitha dilemat e Operatorit Ekonomik ankues lidhur përgatitjen profesionale dhe qëllimin e konstatimit me këtë ekspertizë si dhe me ekspertizën paraprake.

Andaj mbi këtë bazë Ekspertja shqyrtuese konstaton se pretendimi është i pabazuare .

### **Përgjigje në Pretendimi nr.7**

O ankues” Malsia NPG”, pretendon se Kuvendi Komunal Vushtrri, nuk ka respektuar nenin72 të LPP-së .

Meqë kjo pikë pretenduese nuk ishte edhe me Kërkesën për Rishqyrtim, e njëjta nuk mund të shqyrtohet nga Ekspertja e Prokurimit konform rregullave të brendshme të OSHP-së

Mendimi i ekspertesprofesionale:Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura,ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesën e lartpërmendur të operatorit ekonomik ankues HUDHË POSHT SI TËPA BAZUARË (për arsyen që u cekën për secilin pretendim),dhe rekomandon të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës 27.12.2019 ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me raportin e ekspertesprofesionale, ndërsa Autoriteti Kontraktues nuk ka kthyer përgjigje.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 13.01.2020, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dheanalizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi iinimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.



Lidhur me pretendimin e OE ankues "Malësia NPG", se Kuvendi Komunal Vushtrri, nuk ka respektuar nenin 1 të LPP-së, pasi që e ka shpallur fitues OE "ER-LIS"SH.P.K-NNT "EingCom". AK duhet të ketë në konsideratë qëllimin e këtij ligji ku dihet se qëllim i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional Ekspertja thekson se qëllim i këtij neni është të sigurojë mënyrë ma efikase ,me transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike ,duke përcaktuar kushtet rregullat që do të zbatohen , procedurat që do të ndiqen ,te drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen, andaj trajtimi i OE, ankues si OE i Eliminuar pasi që nuk i ka plotësuar kriteret e parapara me NJ.K. dhe D.T. është në harmoni me nenin 1 të LPP-së, nga kjo rrjedh se pretendimi i ankuesit në këtë pikë është i pabazuare .

Lidhur me pretendimin e OE "Malsia NPG", se Kuvendi Komunal Vushtrri, nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së, ky nen është shkelur pasi që AK-ja, nuk i ka vlerësuar të gjithë OE njësoj .

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se qëllimi i nenit 7 të LPP-së është që AK ti trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë, pa diskriminim dhe në mënyrë transparente. AK gjatë Ri-vlerësimit, Operatorin Ekonomik ankues, e ka trajtuar si OE të eliminuar ngase ishte ofertë me gabime në kalkulim mbi normën e lejuar +-2% ,duke sqaruar se kjo ishte vërtetuar edhe nga paneli shqyrtues përkatësisht me vendimin PSH.nr. 465/19 të datës 08.10.2019, ishte ofertë me gabime që tejkalon normën e lejuar andaj edhe nuk i plotëson kriteret e parapara me Njoftimit për kontratë dhe dosjen e tenderit, andaj rrjedh se pretendimi i OE ankues nuk qëndron.

Lidhur me pretendimin e "Malsia NPG", se Kuvendi Komunal Vushtrri, nuk ka respektuar nenin 39 të Rregullat e Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik ,(sqarimi i tenderëve )sipas OE. Ankues dhe nenin 59 i LPP-së si dhe neni 41 i RRUOPP-it (Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve ).

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se qëllimi i nenit 59 të LPP-së dhe nenit 41 të RRUOPP-it është Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve , sqarojmë se fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të Ri-vlerësimit i cili OE-në ankues e ka trajtuar si OE të eliminuar dhe trajtimi si OE i eliminuar Operatorin ekonomik ankues është në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe nenin 41 të RRUOPP-it. Pikërisht neni 39 i RRUOPP përkatësisht pika 39.2 e rregullon-sqaron këtë pikë pretenduese shih piken 39.2 Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt të tenderit nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet.



Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional sqaron se, nëse analizohet siç e ka dorëzuar ofertën OE ankues fillimisht në mënyrë fizike dhe pretendimin që tani edhe ja ka bashkangjitur ankesës me përshkrimin e çmimit, shihet qartë se është ndryshuar tërë oferta të çmimi për tvsh. Kurse neni 39.2 nuk lejon që të bëhet asnjë ndryshim në çmim .

OE ankues të plotësimi i përshkrimit të çmimeve ka gabuar sepse :

OE ankues nuk e ka përdor tabelën (përshkrimin e çmimeve) të krijuar nga AK-së në platformën e-prokurimit ose e ka përdor tabelën por nuk ju ka përmbajtur udhëzimit që ishte dhënë se si të plotësohet tabela sepse udhëzimi ishte:

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G

Në kolonën F duhet të plotësoni duke shkruar normën e tvsh-së vetëm si numër si 0,8 ose 18 e jo në formatin 0% ,8%,apo 18%,

Ndërsa në kolonën G duhet ta plotësoni me çmim për njësi me tvsh, çmimin duhet ta shkruani me dy decimale pas presjes dhjetore .

OE ankues nëse e ka përdor përshkrimin e çmimit të krijuar nga AK përmes platformës së e-prokurimit, të çmimi për njësi me tvsh e ka dhënë çmimin që përputhet me totalin e çmimit të ofertës, mirëpo i njëjti gabimisht te norma e tvsh-së, nuk ju kishte përmbajtur udhëzimit dhe gabimisht e ka shkruar vlerën e tvsh-së e jo sikurse ishte udhëzuar ta paraqet vetëm me 0.8 ose 18 andaj edhe tabela formula e ndryshon edhe çmimin për njësi dhe me këtë veprim ndryshohet tërë oferta sepse ndryshohet çmimi për njësi pa tvsh dhe bazuar në këtë çmim ndryshon tërë oferta dhe bien ndesh me piken b të nenit 41 të RRUOPP-it ku ekskluzivisht e përcakton se „Në asnjë rast çmimi për njësi nuk mundë të korrigjohet. Në rast se tenderuesi pretendon se ka bërë në gabim në çmimin për njësi,tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet i tërhequr.

Por edhe në rast se OE ankues fare nuk e ka përdor Tabelën (përshkrimin e çmimeve ) të krijuar nga AK por ka krijuar tabelë vetë në Exel prapë se prapë ka vepruar gabimisht sepse Dallimi i gabimit aritmetik e tejkalon normën e lejuar +, - 2% duke u bazuar në Nenin 59 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Paneli shqyrtues sqaron se Ekspertja e prokurimit ka kalkuluar vetëm 4 pozicione si me ekspertizën paraprake dhe ka analizuar edhe pretendimet e OE ankues në tabelën e dorëzuar me ankesë dhe vjen në përfundim se OE ankues gabimisht e ka ndryshuar tabelën -përshkrimin e çmimit ku e ka ndryshuar komplet çmimin për njësi duke dhënë vlera për njësi që i përshtaten totalit të çmimit që kjo nënkupton ndryshim të ofertës.

Totali i ofertës i dhënë nga OE me rastin e dorëzimit të ofertës:



Totali i çmimit pa tvsh = 62,484.52 €  
Totali i TVSH-së = 3,764.04 €  
Totali i çmimit me TVSH = 66,248.56 €

Totali i ofertës i korrigjuar nga OE. me rastin e dorëzimit të ankesës:

Totali i çmimit pa tvsh = 56,321.32 €  
Totali i TVSH-së = 9,927.24 €  
Totali i çmimit me TVSH = 66,248.56 €

Dallimin në kalkulim të totali i çmimit pa tvsh është më tepër se +/- 2%

$62,484.52 - 56,321.32 = 6,341.67$  € dmth gabim në kalkulim sipas ofertës së dorëzuarë nga OE ankues dhe ofertës së korrigjuar me ankesë nga vetë OE ankues është 6,341.67 € kurse Norma e lejuar e gabimit aritmetik sipas formulës  $56,142.85 * 2\%$  është 1,122.85 €

Këto të gjetura pa e përdor kalkulimin paraprak të cilin e kam bërë vërtetohet se gabimet në kalkulim e tejkalojnë normën e lejuar, që norma e lejuar për gabime gramatikore është deri 1,122.85 € kurse vet OE ankues ka konstatuar se ka gabime të totali pa tvsh gabimi është në vlerë prej 6,341.67 €.

Mbi këtë bazë është vërtetuar se ka gabime në kalkulim mbi normën e lejuar andaj konstatojmë se AK me rastin e Ri-vlerësimit ka nxjerr vendim konform LPP-së dhe RRUOPP-ik

Kalkulimi paraprak nga ekspertja e prokurimit i vetëm 4 pozicioneve me tabelë duke filluar kalkulimin nga çmimi për njësi pa tvsh duke e nxjerr tvsh-në pastaj çmimin për njësi me tvsh pastaj çmimi total me tvsh dhe çmimin total të dhënë nga OE ankues dhe në fund ndryshimin e totalit (detajet janë në raportin e eksperti shqyrtues profesional).

Paneli shqyrtues konstaton se dallimi i gabimit aritmetik të ofertës së OE ankues e tejkalon normën e lejuar +/- 2%, andaj duke u bazuar në Nenin 59 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ,kjo nga fakti se edhe Ekspertja e prokurimit ka kalkuluar vetëm 4 pozicione dhe është vërtetuar se ka gabime në kalkulim mbi normën e lejuar.

Paneli shqyrtues konform eksperti shqyrtues profesional konstaton se është i pa qëndrueshëm pretendimi i ankuesit kur ai pretendon se ka gabime vetëm në TVSH dhe për të njëjtat nuk vlen rregulla +/- 2% ,është i pa qëndrueshme ky pretendim për faktin se sikur të ishte gabimi vetëm në TVSH do ishte në rregull dhe te njëjtat nuk do kishin paraqitur problem sepse është e qartë dhe për të njëjtin çështje jo vetëm se ka jep interpretim KRPP-ja por ajo çështje është e gjykuar sepse ka vendim nga OSHP-ja që gabimet në TVSH i

ka trajtuar si gabime që nuk hyjnë te rregulli +-2%, mirëpo rasti i OE ankues hyn te gabimet në kalkulim siç e sqaruar edhe më lart te totali pa TVSh sepse e tejkalojnë normën e lejuar .

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues ka vepruar në këtë mënyrë duke i ndryshuar çmimet për njësi shih vetëm katër pozicionet e para :

Pozicioni 1 çmimi për njësi në vend të çmimit 1.79 ju e ka ndryshuar në çmim 1.53

Pozicioni 2 çmimi për njësi në vend të çmimit 0.90 ju e ka ndryshuar në çmim 0.76

Pozicioni 3 çmimi për njësi në vend të çmimit 7.89 ju e ka ndryshuar në çmim 6.78

Pozicioni 4 çmimi për njësi në vend të çmimit 7.89 ju e ka ndryshuar në çmim 6.78

Kështu kishte vepruar në të gjitha njësit dhe gabimisht e kishte ndryshuar tërë ofertën .

Ky veprim bien në kundërshtim me piken b të nenit 41.9 të RRUOPP-kë, Ekzaminimi ,vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve ,ku ekskluzivisht e rregullon këtë çështje te njëjtin normë citat :

„Në asnjë rast çmimi për njësi nuk mund të korrigohet .Në rast se tenderuesi pretendon se ka bërë një gabim në çmim për njësi ,tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet i tërhequr”

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se dispozita e nenit 41.9 pika b. vetëm e përcakton se çmimi për njësi nuk mund të korrigohet dhe se në rastin kur tenderuesi pretendon se ka bërë një gabim në çmim për njësi ,tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet i tërhequr” andaj Ligji dhe RRUOPP , nuk flasin veç e veç për çmim për njësi pa TVSh dhe çmim për njësi me TVSh, andaj mbi këtë bazë ligjore vij në përfundim se sipas kësaj dispozite nuk ka ndonjë ndarje që do të lejonte korrigjimin e çmimeve për njësi pa TVSh siç ka vepruar OE ankues në tërë ofertën.

Lidhur me pretendimin e OE ” Malsia NPG”, se Kuvendi Komunal Vushtrri, nuk ka respektuar nenin 72 të LPP-së .

Paneli shqyrtues duke pas parasysh faktin se kjo pikë pretenduese nuk ishte edhe me kërkesën për Rishqyrtim, andaj konstatojmë se me rastin e marrjes së këtij vendimi, PSH është bazuar në pretendimet ankimore që kanë qenë të njëjta si tek kërkesa për rishqyrtim ashtu edhe tek ankesa e dorëzuar në OSHP, sepse në nenin 9.2 tek Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave, shkruan decidivisht se pretendimet ankimore duhet të jenë të njëjta me ato te paraqitura në Autoritetin Kontraktues, ndërsa çdo pretendim



tjetër që është ngritur në ankesën e dorëzuar në OSHP dhe që nuk ka kaluar nëpër filtrat e rishqyrtimit tek autoriteti kontraktues nuk është marr parasysh dhe nuk është i përfshirë në këtë vendim .

Paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve për aktivitetin e prokurimit në fjalë është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, konform nenit 60 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi ku refuzoj ankesën e OE ankues dhe vërtetoi vendimin e AK-së/ Njoftimin për dhënie të kontratës.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



**Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK- Kuvendi Komunal Vushtrri
- 1x1 OE-: "Malesia"- Istog
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.